

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	00 Nr.32/2022	Data: 31.03.2022	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 11, 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14, paragrafi 14.1 dhe 14.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenit 13 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019); nenit 6, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 83, paragrafi 83.1 dhe 83.2 të Statutit 01 Nr.62/2010 të Komunës së Istogut, lidhur me publikimin e listës së veçantë të pronave të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2022, miratojë këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2022

1. **MIRATOHET** *Lista e veçantë* e pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitin 2022.
2. Pjesë e këtij vendimi është *Lista e Veçantë* e pronave të paluajtshme të Komunës për dhënie në shfrytëzim për vitin 2022 të verifikuara dhe përpiluara nga Komisioni i Komunës sipas vendimit 01 Nr.146/2022 të datës 17.03.2022.
3. Procedura e dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës do të jetë në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi.
4. Dhënia në shfrytëzim e pronave të paluajtshme të komunës ka për qëllim zhvillimin ekonomik dhe interesin publik të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria e Inspektionit, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Pas miratimit të këtij Vendimi nga Kuvendi i Komunës dhe dërgimit të tij në MAPL për konfirmimin e ligjshmërisë, i njëjti hyn në fuqi ashtu siç është përcaktuar në nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 17 të Rregullores (MAPL) për Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve apo ueb faqen e Komunës.

Vendimi t'i dorëzohet: Zyrës së Kryetarit, Drejtorive përkatëse të lartcekura, MAPL-së, Zyrës së Përkthimeve, Zyrës së Kuvendit dhe Arkivës.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE

Uales/Izlazna

00 Nr. 032 - 16

Br:

Data 31.03.2022
 Datum

Kryesuesi i Kuvendit,
 z. Enver Rugova

